



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.2.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 11.02.2021.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku, Rolant Xhelilaj, Klotilda Bushka, Almira Xhembulla dhe Halil Jakimi.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Antoneta Njehrrëna – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Besart Kadia – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave
Eralda Shtylla – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
Flogers Broqi – Përfaqësues nga QKB-ja

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Të nderuar deputetë, mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite:

Së pari, kemi miratimin e procesverbalit të datës 11.02.2021. A jeni dakord me procesverbalin e datës 11.02.2021? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Së dyti, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””. Kjo është një nismë e Këshillit të Ministrave dhe komisioni ynë është në cilësinë e komisionit përgjegjës. Relatore për këtë projektligj është dokoreshë Edlira Bode.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrin pjesë: zonja Mira Rakacolli, zëvendësministre, dhe zonja Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike; nga QKB- ja kemi zotin Flogers Broqi; nga Ministria e Ekonomisë kemi zotin Besart Kadia, zëvendësministër, dhe Eralda Shtyllën, përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik.

Mirë se erdhët në mbledhjen e komisionit!

Sipas procedurës, ia japim fjalën zëvendësministres së Shëndetësisë, zonjës Mira Rakacolli, për të bërë prezantimin e projektligjit.

Mira Rakacolli – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet që po bëhen sot me anë të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””, janë ndryshime që kërkohen nga ligji “Për pajisjet mjekësore”, të cilin Kuvendi i Shqipërisë e miratoi vitin e kaluar.

Në këtë ligj, pikërisht në nenet 21 dhe 22 të tij, kërkohet që prodhimi dhe tregtimi i pajisjeve mjekësore të bëhet nga subjekte, të cilat duhet të jenë të licencuara. Kriteret e licencimit janë ato kritere, të cilat përcaktohen në të gjitha dokumentet rregullatore që janë përgjegjëse për këtë gjë.

Prandaj, propozimi ynë është që në shtojcën e këtij ligji të shtohet edhe: “licenca për ato subjekte, të cilat do të kenë të drejtë për të tregtuar, për të prodhuar dhe/ose për të tregtuar pajisje mjekësore me shumicë”.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Atëherë, fjalën e ka zëvendësministër i Financave, zoti Besart Kadia, të cilit i uroj suksese në detyrë! Mirë se erdhët në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë!

Fjala për ju, zoti Kadiu, në qoftë se keni diçka për të shtuar në lidhje me projektligjin. A keni ndonjë koment?

Besart Kadia – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për fjalën!

Duke qenë se Ministria e Financave dhe Qendra Kombëtare e Biznesit do të merren me pjesën e licencimit dhe me detajet e tjera, nuk kemi komente për sa i përket amendimit. Në bazë të vendimit nr. 538 të vitit 2009 “Për licencat e lejet që trajtohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare për Biznesin”, të ndryshuara, këto detaje do të reflektohen në VKM.

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Besart!

Atëherë, sipas procedurës, ia jap fjalën relatores për të bërë sugjerimet dhe vërejtjet rreth këtij projektligji.

Fjala për ju zonja Bode.

Edlira Bode – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, nuk kam shumë për të shtuar, pasi është vetëm një pikë në këtë projektligj që shqyrtojmë sot, pra është një pikë që bën funksional një ligj që ne vetë e kemi miratuar vitin e kaluar. Kemi miratuar ligjin “Për pajisjet mjekësore”, në të cilin kemi shkruar: “Subjektet që prodhojnë dhe tregtojnë pajisje mjekësore me shumicë duhet të jenë të licencuara”, siç e tha shumë mirë zonja zëvendësministre. Kjo gjë mungon te ligji bazë “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i cili është i vitit 2009. Pra, thjesht te shtojca e këtij ligji shtojmë edhe pikën ku flitet për prodhim dhe/ose tregtim të pajisjeve mjekësore. Është një rregullim ligjor që bën funksional një ligj që ne e kemi miratuar vetë.

Ftoj kolegët të votojnë pro këtij ndryshimi.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Bode!

Fjalën e kanë deputetët për të bërë pyetje. A ka pyetje dhe komente në lidhje me projektligjin? Nuk ka.

Atëherë, kam unë një pyetje.

Në lidhje me pajisjet mjekësore në pjesën ku thuhet: autorizohen subjektet për të bërë importin e tyre, dua të di se cili do ta bëjë monitorimin, ndjekjen dhe kontrollin e pajisjeve mjekësore? Cili është institucioni që do të bëjë ndjekjen dhe kontrollin e pajisjeve mjekësore?

Mira Rakacolli – Besoj se kjo duhet të jetë e përcaktuar në ligjin për pajisjet mjekësore. Nga sa më kujtohet kur kemi diskutuar ligjin për pajisjet mjekësore kjo gjë është e shprehur.

Enver Roshi – Pyetja e dytë. Në ligjin për pajisjet mjekësore ju kemi bërë një pyetje sa u takon pajisjeve mjekësore që dalin jashtë përdorimit. Si bëhet grumbullimi, zhdukja dhe eliminimi i tyre?

Këtë çështje e kemi ngritur edhe më parë dhe prapë ngelet si pikëpyetje sa i takon ligjit për pajisjet mjekësore, e cila duhet të gjejë zgjidhje nga ana juaj.

Do të vijë koha dhe do të kemi një sërë pajisjesh mjekësore, që do të dalin jashtë përdorimit për shkak të vjetërsisë apo amortizimit të tyre dhe ne nga një vend që importon pajisje mjekësore të garantuara dhe të mira do të kthehemi në një vend që grumbullon shumë mbeturina. Si mund të zgjidhet kjo çështje, a ka Ministria e Shëndetësisë ndonjë politikë në lidhje me këtë?

Mira Rakacolli – Faleminderit, që e ngritët këtë shqetësim!

Ky është një shqetësim që ne e kemi pasur, ashtu siç e thatë edhe ju, është ngritur edhe atëherë kur kemi diskutuar problemin e kalimit të ligjit për barnat dhe pajisjet mjekësore. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim, aq më tepër tani që bëhet fjalë edhe për aparatura, të cilat shfrytëzojnë burime të lëndëve jo shumë të shëndetshme, për ta vënë në baza ligjore të përcaktuara shumë mirë dhe besoj se shumë shpejt do të jetë në tavolinën tuaj.

Enver Roshi – Faleminderit!

Ne presim që ky projektligj të vijë sa më parë, sepse nuk bëhet fjalë vetëm për pajisje mjekësore që janë inerte dhe kanë pak dëm në mjedis, por edhe për pajisje mjekësore që përdoren në radioterapi ose për sëmundje të tjera ku futen edhe përdorimi i joneve dhe i mjekësisë radioaktive.

Mira Rakacolli – Pikërisht këtë pata parasysh kur thashë që janë të dëmshme për shëndetin.

Enver Roshi – Faleminderit!

A ka ndonjë tjetër që dëshiron ta marrë fjalën?

A ka ndonjë koment nga të ftuarit? Nuk ka.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Financave!

Ju uroj një ditë të këndshme!

Mirë u pafshim në takimin tjetër!

MBYLLET MBLEDHJA